Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Shkelzen Hoxha	**16.11.2023**	**23.11.2023**	**2023/0905**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.11.2023, OE "Eor Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0905, kundër, NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES ku është rekomanduar anulimi i aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Gjenerator" me nr. të prokurimit: "651-22-12442-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 160,350.00 €.

Është e përsëritur ankesa, lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më PSH Nr. 790/22 i publikuar me datë: 24/03/2023 dhe OSHP: Nr. 0212/2023 i publikuar me datën: 21/07/2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

17.11.2022 Njoftimi për Kontratë

29.11.2022 Afati i fundit per dorzimin e tenderave ishte ne ora 14:30

29.11.2022 Proces verbali i hapjes se Tenderve

08.12.2022 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK

08.12.2022 Kërkesa për çasje në dokumenta

09.12.2022 Çasja në dokumenta

11.12.2022 Kërkesa për rishqyrtim

12.12.2022 Vendim për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim

20.12.2022 Ankesa OSHP

27.03.2023 Vendimi i OSHP-së

31.03.2023 Njoftimi i AK dhe Letrat Standarde

03.04.2023 Çasja në dokumenta

04.04.2023 Kërkesa për rishqyrtim

06.04.2023 Vendimi mbi kërkesen për rishqyrtim

15.04.2023 Ankesa edytë në OSHP

18.04.2023 Pezullimi i aktivitetit

21.07.2023 Vendimi i dytë I PSH të OSHP-së

01.11.2023 Njoftimi i AK-së dhe Letrat Standarde

05.11.2023 Kërkesa për rishqyrtim

07.11.2023 Vendimi mbi Kërkesen për Rishqyrtim 3 Kriteri per dhenjen e kontrates ishte çmimi me i lirë.

Kërkojmë nga PSH i OSHP qe të detyrojë Autoritetin Kontraktues te anulojë vendimin e dates 01.11.2023 sepse vendimi I AK-së i dates 01.11.2023, ka elemente qe zyrtarë të AK-së kanë bër veper penale, të detyrohet AK-ja të kthehej lënden në RI-VLERSIM, AK-ja të punojë konform dispozitave te LPP-së, Vendimeve Nr. 790/22 dhe Nr. 0212/2023 te PSH të OSHP-së dhe të shperblehet me kontratë Grupi i OEve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SHPK pasi qe jemi (grup) OE e vetëme e përgjegjëshem qe i plotsojmë të gjitha kerkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe FTD të dosjes te tenderit me çmim të ofruar brenda buxhetit të paraparë nga Autoriteti Kontraktues.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur rend dispozitat e LPP-së, pasi qe ka shkelur rënd Nenet të LPP-së:

Neni 1- Qellimi Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit Shkelja e Vendimit Nr. 0212/2023 te PSH të OSHP-së të dates 21.07.2023 për të ekzekutuar këtë vendim nga AK-ja, ku AK-ja i tejkalonë të gjitha afatet kohore të parapara me LPPpër marrjen e vendimit, ku Autoriteti Kontraktues me vonesë prej 100 ditëve pas vendimit të PSH të OSHP-së shpall: Njoftimin për anulim të tenderit, me date: 01.11.2023, ky vendim ngritë shumë dyshime?!!!

Grupi i OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SHPK për here të tretë i drejtohet PSH të OSHPsë pasi qe Autoriteti Kontraktues vazhdimisht bën shkelje të rënda të dizpozitave te LPP-së dhe vendimeve te PSH të OSHP-së, të cilat shkelje në menyrë recidive i

përserit Autoriteti Kontraktues dhe për me keq kësaj radhe bën shkelje të rëndë edhe të Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe një herit me këtë rast Autoriteti Kontraktues me veprimet e veta dhe arsyetimin e dhënë në njoftimin e vendimit të dates 01.11.2023 në këtë aktivitet ka bër edhe veper penale.

Pas pranimit të njoftimit me daten 01.11.2023: Vendimi i Autoriteti Kontraktues dhe letrat standarte, me datën 05.11.2023 kemi derguar Kërkesen për rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues dhe i kemi treguar se sipas Neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1 thotë se Autoriteti Kontraktues mundë të përfundojë aktivitetin e prokurimit, neni 62 paaragrafi 2 dhe 2.1 vetem në këto raste:

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Bazuar në LPP dhe kërkesat e FTD të dosjes se tenderit Grupi i Operatorve Ekonomk EOR GROUP SH.P.K & CONTANTI GENERATORS SH.P.K është i përgjegjëshem sipas FTD të dosjes se tenderit, pasi qe ka vazhduar validitetin e ofertës pa shkputje dhe ka ofruar çmimin e ofertës brenda buxhetit të paraparë nga Autoriteti Kontraktues, në këtë rast Autoriteti Kontraktues bazuar në Nenin 62 nuk mundë të anuloi tenderin (përfundoi aktivitetin e prokurimit).

Autoriteti Kontraktues me vendimin e 01.11.2023 ka shkelur rëndë dispozitat e LPP-së, gjegjësisht nenin 62 paragrafi 2 dhe 2.1 kur e ka anuluar tenderin! Në arsyetimin e dhënë me vendimin e dates 01.11.2023 një herit ka elemente të vepres penale kur thotë se mjetet të cilat kanë qenë të destinuara për projekt janë shpenzuar në një project tjeter, ky veprim i AK-së është veper penale dhe tejet skandaloz, ku ka të bejmë me shkelje të rendë të dispozitave të LPP-së dhe një herit sipas arsyetimit të dhënë nga AK-ja në vendimin e 01.11.2023 zyrtaret e involvuar në këtë vendim kanë bër veper penale. Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të njoftoi Prokurorinë e Shtetit dhe Njesinë e Krimeve Ekonomike të Minsitrisë se Punëve të Brendëshme për vepren penale të bër nga Autoriteti Kontraktues dhe të hetohen zyrtaret e AK-së të cilet e kanë keqperdorë poziten zyrtare dhe i kanë keqperdorur mjetet financiare në kundershtim me ligjin.

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e dates 01.11.2023 dhe të detyrojë Autoritetin Kontraktues të kthej lënden në ri-vlersim ku do të shplall fitues Konzorciumin i OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K pasi qe grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K jemi te vetmit të përgjegjëshme dhe plotsojmë kërkesat e dhëna ne dosjen e tenderit dhe një herit kemi ofruar ofertë brenda buxhetit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues siq e parashihet edhe me LPP-ja, se me këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk mundë të nderpres aktivitetin.

Në vazhdim të ankeses do të paqesim faktet dhe argumentet detalisht ku Autoriteti Kontraktues pasi qe bazuar në vendimet e PSH të OSHP-së nuk arrinë të shperblej me kontratë OE INFINIT SHPK të cilen e favorizonte, merr vendim të kundër ligjëshem dhe shpall Njoftimin për anulimin e tenderit dhe kjo është veper penale sipas arsyetimit të dhën nga Autoriteti Kontraktues. Kur sipas LPP-së mjetet financiare duhet të sigurohen para publikimit të njoftimit për kontratë dhe nuk lejohen të shpenzohen për aktivitete tjera deri në përfundimin e procedures për të cilen janë

ndarë mjetet.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Duke marrë për bazë LIGJI_NR._05_L-092_PËR_NDRYSHIMIN_DHE_PLOTËSIMIN_E_LIGJIT_NR._ 04_L 042_PËR_PROKURIMIN_PUBLIK_TË_REPUBLIKËS_SË_KOSOVËS_I_NDRYSHUAR_DHE_ PLOTËSUAR _ME_LIG si dhe duke u bazuar në RUOPP kërkesat minimale të dhëna me Njoftimin për Kontratë dhe kërkesat e dhëna me Dosjen e Tenderit janë të plotsouara në tërsi, kërkojmë qe Operatori Ekonomik EOR GROUP SH.P.K & CONTANTI GENERATORS SH.P.K të shpallet fitues.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bër shkelje të vazhdueshme të dispozitave të LPPsë dhe vendimeve të PSH të OSHP-së duke mos respektuar afatet kohor për marrjen e vendimit, mos respektimi i vendimeve të OSHP-së, kur pas vendimit të dates 21.07.2023 me Nr. 0212/2023 te PSH të OSHP-së deri në marrje të vendimit ka shkelur rend afatet kohore të parapara me ligj dhe ka shkelur rend dispozitat e LPP-së pasi qe nuk ka respektuar nenet e LPP-së si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Shkelja e Vendimit të dates: 21.07.2023 me Nr. 0212/2023 te PSH të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues për të ekzekutuar këtë vendim i tejkalonë të gjitha afatet kohore të parapara me LPP, ku Autoriteti Kontraktues me vonesë prej 100 ditëve, nga data e vendimit të PSH të OSHPsë, me: 21.07.2023, Autoriteti Kontraktues me date: 01.11.2023 shpall: Njoftimin për anulim të tenderit, (kohëzgjatja me teper se 100 ditë)

Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik ka ndodhur nga Autoriteti Kontraktues vazhdimisht në dy ankesat paraprake.

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ta detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e dates: 01.11.2023 dhe të detyrojë Autoritetin Kontraktues të kthej lënden në rivlersim ku do të shplall fitues grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K pasi qe jemi OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K te vetmit të përgjegjëshme dhe plotsojmë kërkesat e dhëna ne dosjen e tenderit dhe një herit jemi brenda buxhetit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues siq e parasheh edhe në LPP.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Kërkojmë nga PSH i OSHP që ta detyrojë Autoritetni Kontraktues qe të anulojë vendimin e datës 01.11.2023 dhe të kthehetë lënda në RI-SHQYRTIM, dukë marrë për bazë vendimin Nr.790/22, vendimin 0212/2023 dhe nenin 62 paragrafi 2 dhe 2.1 dhe faktet tjera te prezantuara për shkeljet e dispozitave të LPP-së qe kanë ndodhur nga AK-ja. Të merret vendimi i ri ku do të shperblehet me kontratë Grupi i OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SHPK, pasi qe në bazë të kerkesave të Dosjes se tenderit ne jemi OE e vetme të përgjegjëshem dhe i plotsojmë të gjitha kerkesat e dhëna me me dosjen e tenderit dhe kemi ofruar çmim brenda buxhetit të

paraparë të Autoritetit Kontraktues.

Duke marrë për bazë LIGJI_NR._05_L-092_PËR_NDRYSHIMIN_DHE_PLOTËSIMIN_E_LIGJIT_NR._04_L042_PËR_PROKURIMIN_PUBLIK_TË_REPUBLIKËS_SË_KOSOVËS_I_NDRYSHUAR_DHE_PLOTËSUAR _ME_LIG si dhe duke u bazuar në RUOPP kërkesat minimale të dhëna me Njoftimin për Kontratë dhe kërkesat e dhëna me Dosjen e Tenderit janë të plotsouara në tërsi, kërkojmë qe Operatori Ekonomik EOR GROUP SH.P.K & CONTANTI GENERATORS SH.P.K të shpallet fitues.

Faktet e cekura për të anuluar vendimin e AK-së të dates 01.11.2023 dhe për të kthyer lënden në ri vlersim dhe të detyrojë Autoritetin Kontraktues të shperblej me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K, janë:

I. Autoriteti Kontraktues në period prej 1 viti vazhdimishtë e ka zvarritur lënden duke favorizuar OE INFINIT SHPK i cili është OE e pa përgjegjëshme, dhe për kunder dy vendimeve të PSH të OSHP-së , Vendimet Nr. 790/22 dhe Nr. 0212/2023 te PSH të OSHP-së qe kanë qenë në favor të grupit të OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K. Autoriteti Kontraktues kur ju shterren të gjitha mundësit për ta shperblyer OE INFINIT fitues, Autoriteti Kontraktues shkel rend nenin 62 të ligjit dhe bën veper penale duke marr vendim për anulimin e tenderit.

KONKLUZION: Edhe në dy ankesat e drejtuara për këtë tender gjithë here kemi cekur se dyshojmë se ketu ka interesa të individve apo grupi të individve të cilet janë vazhdimisht duke shkelur dispozitat e LPP-së për interesa të individve apo grupi të individve. Me vendimin e dates 01.11.2023 vetem sa Autoriteti Kontraktues dhe zyrtaret e përrfshirë në këtë tender, vetem sa e kanë vertetuar dhe konfirmuar dyshimet tona se kanë interesa të tyre kur në kundershtim me neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1 e marrin vendimin për anulimin e tenderit.

II. Duke pas parasyshë qe PSH i OSHP-së ka marrë vendimin e dytë me daten 21.07.2023 në ankesen e drejtuar nga grupi i OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K se venidimi është i bazuar dhe ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues lënda të kthehet në rivlersim. Autoriteti Kontraktues pas këtij vendimit 0212/2023 duke pa se nuk ka mundësi të favorizoj dhe shperblej me kontratë OE INFINIT e zvarrit lënden dhe nuk sjell vendim konformë kërkeses te PSH të OSHP-së qe të sjell vendim brenda afatit të kërkuar nga PSH I OSHP-së që në afat prej 10 ditëve siç është cekur në vendim: 2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

Lënda është zvarritur nga AK-ja për me shumë se tre muaj (100 ditë) , atëhere grupi i OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K ju ka drejtuar me kerkes PSH të OSHP-së me date: 31.08.2023, 28.09.2023 dhe me date 26.10.2023 qe të detyroj Autoritetin Kontraktues të respektoi afatet ligjore sipas LPP-së për marrjen e vendimit. Pas kërkesave të vazhdueshme qe kemi derguar të PSH të OSHP-së, në kërkesen e fundit qe kemi derguar me 26.10.2023 të PSH i OSHP-së, Paneli i OSHP-së ka drejtuar pytje Autoritetit Kontraktues pse nuk është marr ende vendim. Autoriteti Kontraktues kur nuk kishte mundësi tjera për të favorizuar OE INFINIT, zyrtaret e AK-së qe dyshojmë se kanë "interesa personale kanë krijuar dokumente" të cilat për ne janë të dyshimta "kinse" njesia kërkuese - Drejtoria e Arsimit i ka

shpenzuar mjetet dhe për këtë arsye kërkon të nderpritet procedura. Ky veprim I Autoritetit Kontraktues është veper penale kur dihet se pa e siguruar buxhetin nuk mundë të bëhet Njoftimi për kontratë dhe bazuar në ligj mjetet e ndara për këtë kontratë (tender) nuk mundë të shfrytzohen për qellime tjera pa përfunduar procedura as nuk mundë të ri destinohen mjetet. Mjetet e ndara për këtë kontratë nuk mundë të shfrytzohen për qellime tjera, deri sa procedura është në vlersim apo si në këtë rast në OSHP. Shfrytzimi i këtyre mjeteve siç ceket në arsyetimin e vendimit të dates 01.11.2023 është veper penale, dhe cili do zyrtarë apo kushdo qe e ka pergaditur kërkesen për nderprerjen e aktivitetit ka bër veper penale dhe duhet të lajmrohet Prokuroria e Shetit, Krimet Ekonomike dhe të fillojnë hetimet ndaj këtyre zyrtarve. Nuk është askush mbi ligjin e aq me pakë zyrtaret të cilet paguhen nga taksat e qytetarve të Republikës se Kosoves për ta mbrojtur ligjin e jo për ta shkelur ligjin!!!

KONKLUZION: Autoriteti Kontraktues bën veper penale kur me daten 26.10.2023 merr kerkes nga PSH i OSHP-së , të tregoi pse në afat prej 100 ditëve nuk është perfunduar lënda. Individë apo grup i individve nga AK-ja në bashkpunim bëjn veper penale kur brenda nje dite me 27.10.2023 nxjerrin dokumentin se duhet të nderpritet aktiviteti i prokurimit kinse e kanë shfrytzuar buxhetin për aktivitete tjera. Ç'farë koincidence me 26.10.2023, PSH I OSHP-së kërkonë sqarim nga Autoriteti Kontraktues, me 27.10.2023 njesia Kërkuese- Drejtoria e Arsimit kërkon anulimin e aktivitetit se mjetet e parapara për këtë aktivitet janë shpenzuar. Ky fakt paraqet pasqyren e saktë qe kemi prezantuar edhe në dy ankesat paraprake për këtë aktivitet kur pretendonim se individ apo grup I individve kanë interesa personale për deri sa hapurazi po e favorizojnë OE INFINIT. Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të njoftoi Prokorurin e Shtetit dhe Krimet Ekonomike qe të fillojnë me hetimin e kesaj vepre penale të bër nga zyrtaret e përfshirë të Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet.

III. Autoriteti Kontraktue nga vendimi i pare dates: 08.12.2022, vazhdimisht shklel rënd neni 1, neni 7 dhe dispozitat e cekura në dy ankesat paraprake, po ne rastin e vendimit të dates 01.11.2023 bën shkelje të rënd edhe të nenit 62 paragrafi 2 dhe 2.1. kur tenton për interesa të individve apo grupi të individve të anuloi tenderin në kundershtim me neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1, pasi qe në këtë faze Autoriteti Kontraktues nuk munë të anuloi tenderin kur grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K jemi të përgjegjëshem dhe brenda buxhetit të paraparë për këtë tender.

KONKLUZION Autoriteti Kontraktues sipas neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1 në këtë fazë nuk mundë të nderprej procedurat e prokurimit. Nderprerja e procedurave të prokurimit në këtë faze është veper penale kur OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K jemi të përgjegjëshem dhe brenda buxhetit siç parashihet me ligj. Ky vendim i AK-së është vetem pasi qe nuk kanë mundësi të shperblejnë OE INFINIT ku fort dyshojmë se ndonjë individ apo grupi i individve nga AK-ja kanë interesa të përbashkta, dhe në pamundësis për ta shperblyer OE INFINIT janë të deshpruar se nuk po arrijnë të favorizojnë OE INFINIT ku në bazë të veprimeve të Autoritetit Kontraktues dyshojmë shumë se kanë interesa të përbashkta dhe marrin vendim të kundër ligjëshem për anulimin e tenderit, dhe në vendimin e dates 01.11.2023 japin arsyetim se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar dhe se e njejta drejtori me nuk posedon mjete te lira, me veprimet e lartë cekura zyrtaret e përfshirë në këtë arsyetim kanë bër veper penale, dyshojmë në arsyetimin e dhënë nga AK-ja, se mjetet i kanë shpenzuar, kur sipas ligj AK-ja nuk guxonë të i shpenzohj mjetet të cilat janë caktuar për një aktivitet të veçanta buxhetore e aq me pak kur lënda është duke u trajtuar në OSHP. Po ky arsyetim jepet nga zyrtarë të cilet në bashkpunim janë bashkëkryers të vepres penale, pasi janë të dëshpruar në pa mundësi

të shperblimit me kontratë të OE INFINIT e sipas sjelljve të AK-së vetem që e forcon bindjen dhe të gjitha faktet qe kemi thënë deri me tani edhe në dy ankesat paraprake se individ apo grup I individve nga AK-ja kanë interesa personale në këtë tender! Dhe për këtë arsye vazhdimisht bëjnë veprime të kundër ligjshme dhe veper penale vetem qe të mbrojnë interest personale.

IV. Autoriteti Kontraktues kur jepë arsyetimin e kunder ligjëshem dhe bënë veper penale: se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar dhe se e njejta drejtori me nuk posedon mjete te lira financiare për këtë vit fiskal, kërkojmë nga PSH i OSHP-së të mos bie në lajthitjen e zyrtarve të "korruptuar" të Autoritetit Kontraktues dhe shkelsit recidivist të ligjit, mirpo PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e dates 01.11.2023 dhe të detyroj Autoritetin Kontraktues të merr vendim konform dispozitave të LPP-së dhe të shperblej grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K. Kërkojmë të merret vendim meritor nga PSH i OSHP-së, ku është i bazuar në LPP dhe të shperblehet me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K, Sa i përket buxhetit zyrtaret Autoriteti Kontraktues për vazhdimin e aktivitetit do të sigurojë mjetet financiare qoftë këtë vit fiskal apo vitin e ardhëshem fiskal për aktivitetin. KONKLUZION Nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së kërkojmë që të merr masa ndaj Autoritetit Kontraktues pasi ka bër shkelje të renda neni 97 paragrafi k, h dhe p të merr masa disiplinore sipas nenit 99 Masat disiplinore për shkeljet të rënda paragrafi 99.2 për zyrtarin e Prokurimit dhe të dënohet AK-ja konform dispozitave të ligjit, ASKUSH NUK ËSHTË MBI LIGJIN!!!. Bazuar në nenin 62 paragrafi 2 dhe 2.1, në këtë faze Autoriteti Kontraktues nuk mundë të nderpritet aktivitetin e prokurimit. Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e dates 01.11.2023 dhe të merret vendimi i ri ku shperblehet me kontratë grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K. pasi qe jemi të vetmit të përgjegjëshem dhe kemi ofruar ofertën brenda buxhetit.

V. Autoriteti Kontraktues kur thotë me daten 27.11.2023 ka pranuar kërkesë nga Njesia KërkueseDrejtoria e Arsimit qe te bej anulimin e aktivitetit me titull: "Furnizimi me Gjenerator" dhe Nr të Prokurimit "GL 651-22-12442-1-1-1" me arsyetimin se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar dhe se e njejta drejtori nuk posedon mjete te lira financiare për këtë vit fiskal dhe kërkon nga zyra e prokurimit te mos vazhdoj me tutje me këtë aktivitet. Kërkojmë nga PSH I OSHP-së të i tërheqet licenca zyrtarit të Prokurimit konform dispozitave të LPP-së për shkak të shkeljeve të renda të LPP-së qe i ka bër zyrtari i Prokurimit kur nuk është marr vendimi nga AK-ja edhe pse PSH i OSHP-së kishte dhënë vendimin me 21.07.2023 dhe AKja pas 100 ditëve me datën 01.11.2023, ka marr vendim për anulim

KONKLUZION Autoriteti Kontraktues duke mos e zbatuar vendimin e PSH të OSHP-së brenda afatit të paraparë ligjor, ka përfituar në kohë dhe ka kërkuar rrugë për të favorizuar OE INFINIT, në momentin kur ju kanë shterr të gjitha mundësit për të shperblyer OE INFINIT, në bashkpunim te drejtorisë te prokurimit dhe drejtorisë te arsimit nxjerrin një dokument, qe dyshojmë shumë në këtë dokument pasi qe është krijuar me 27.10.2023 vetem e vetem, për të mbrojtur interesa të zyrtarve të "korruptuar" për të arritur në qellimet e veta të anulohet tenderi dhe të na pa mundësohet nënshkrimi i kontratës. Ndryshimi i kodeve (linjave) buxhetore mundë të bëhet (ndryshohen) vetem me miratimin dhe votimin e deputetve të Kuvendit Komunal, çdo ndryshim i kodeve buxhetore në fazen kur tenderet janë në procedur dhe sipas neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1 nuk mundë të nderpritet as të shpenzohen mjetet e aktivitetit. Kur aktiviteti është ende duke u shqyrtuar dhe lënda është në gjykatë OSHP, mjetet e siguruara për këtë aktivitet nuk mundë të shpenzohen, dhe në qoftë se mjetet janë shfrytzuar nga zyrtarë të pa përgjegjëshem "Korruptuar"

(individ te cilet e mendojnë veten se janë mbi ligjin!!!) atëhere ky veprim i këtyre individve është veper penale dhe duhet të njoftohen urgjent Krimet Ekonomike dhe Prokuroria e Shtetit për këtë veprer penale. Buxheti miratohet dhe votohet nga deputetet e Kuvendit Komunal dhe nuk mundë të ndryshohet pa aprovim të deputetve të Kuvendit Komunal, nese mjetet shfrytzohen për qellime tjera pra nuk shfrytzohen siç është votuar buxheti nga deputetet e Kuvendit Komunal, atëhere ky veprim i pa autorizuar i zyrtarve të AK-së është veper penale dhe duhet të pergjigjen zyrtaret e përfshirë të AK-së para ligjit për këtë veper penale (skanda). Bazuar në ligjet në fuçi nuk mundë të publikohet Njoftimi për kontratë pa i siguruar mjetet dhe këto mjete nuk mundë të shfrytzohen nga Autoriteti Kontraktues deri sa të përfundon procedura, kjo është perpjekje e Autoritetit Kontraktues të vë në lajthitje OE-në dhe PSH të OSHP-së, kinse nuk ka buxhet se janë shpenzuar mjetet. Po edhe nese janë shpenzuar mjetet, Autoriteti Kontraktues KK Gjilan nuk ka falementuar as nuk është në procedura të shuhet, prandaj PSH I OSHP-së duhet të obligojë Autoritetin Kontraktues qe buxhetin e këtij aktiviteti të sigurohet qoftë për vitin fiskal 2023 ose vitin fiska 2024 në menyrë qe aktiviteti të përmbyllet konform dispozitave të LPP-së. Kërkojmë të njoftohet Prokoruria e Shtetit për vepren penale të cilen e kanë bërë zyrtaret përgjegjës te AK-së, ky konkluzion vjen pasi qe në dy tendera qe kemi marr pjes gjatë vitit 2022 me këtë Autoritet Kontraktues kemi 5 ankesa në OSHP për dy tender dhe për dy tenderet po bëhen nga 3 ankesa për secilin dhe të gjitha ankesat (pesë ankesa) janë kthyer të bazuara nga PSH i OSHP-së, mirpo deri sa në tenderin e pare ku kishim 3 ankesa të bazuara dhe Autoriteti Kontraktues arriti të anuloi tenderin, sikur fitoi guxim Autoriteti Kontraktues dhe tani shkoj aq larg sa qe edhe duke bërë veper penale po tenton të anuloi edhe këtë tender!!! Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues paguhen nga taksat e qytetarve të Republikes se Kosovës për të mbrojutur ligjin dhe të punojnë bazuar në ligj për interesa të gjithë qytetarve të Republikes se Kosovës e jo për ineresa të individve apo grupi të individve duke e dëmtuar rend OE-të dhe ekonomin e Republikës se Kosovës!!!

Për të gjitha shkeljet e rënda të LPP-së që Autoriteti Kontraktues i ka bër deri me tani kërkojmë të njoftohet Prokuroria e Shtetit, Krimet Ekonomike, Mediat.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur rend dispozitat e nenit 97 shkeljet e rënda paragrafi h, k, p h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik. p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP.

Për të gjitha shkeljet e rënda të LPP-së të bëra nga Autoriteti Kontraktues kërkojmë nga PSH I OSHP-së të veproj konform Neni 99 Masat disiplinore për shkeljet të rënda për revokim të çertifikatës së prokurimit.

Do të njoftojmë të gjitha institucionet vendore dhe Ambasaden Amerikane për shkeljet e vazhdueshme të LPP-së që po ndodhin nga Autoriteti Kontraktues KK Gjilan dhe një heri do të kërkojmë ndihmë juridike për dergimin e lëndve të këtij Autoriteti në Arbitrazh Nderkombtar qe po dëmtohemi vazhdimisht pa drejtsishtë nga Autoriteti Kontraktues KK Gjilan

Bazuar në fakte e lartë cekura Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundershtim me vendimin 790/22 dhe 0212/2023 të PSH të OSHP-së dhe ka shkelur rënd Neni 1, Nen 7 , Neni 62 të LPP-së.

Shkeljet e lartë cekura të ndodhur nga Autoriteti Kontraktues, besojmë se AK-ja ka shkelur rënd me dashje apo pa dashje dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të

Republikës se Kosovës). Shkeljet e rënda të dispozitave të LPP-së te cilat janë të vertetuara kanë quar deri ne marrjen e vendimit të gabuar për herë të tretë Autoritetin Kontraktues dhe me vendimin e dates 01.11.2023 AK-ja me arsyetimin e dhënë bën edhe veper penale kur e anulon tenderin. Autoriteti Kontraktues duke mos arrit në qellimet për të favorizuar OE INFINIT merr vendim të kundër ligjshëm dhe e anulon tenderin duke mos e shperblyer me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SH.P.K & CONTANTI GENERATORS SHPK dhe në këtë mënyrë, AK-ja po na mohon te drejta ligjore për shperblimin me kontratë për kryerjen e furnizimeve për këtë aktivitet duke na dëmtuar padrejtësisht dhe duke na mohuar e drejta e jonë sipas LPP-së.

Konzorciumi EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K është i vetmi OE i cili ka plotsuar të gjitha kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe është plotsisht në pajtiushmeri me FTD të dosjes se tenderit dhe çmim të dhënë me ofertë brenda buxhetit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues.

Kërkojmë nga PSH i OSHP-ja që të merr: VENDIM Të obligojë Autoriteti Kontraktues që të anuloi vendimin e dates 01.11.2023 dhe të shplall fitues: Grupin e Operatorve Ekonomik EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SHPK pasi jemi të vetmit në pajtushmeri me kërkesat e FTD të dosjes se tenderit, dhe kemi ofruar çmimin e ofertës brenda buxhetit të paraparë nga Autoriteti Kontraktues. Bazuar në shkeljet e lartë cekura dhe faktet që posedojmë, ne do të vazhdojmë me procedurat ligjore, në të gjitha instancat që parashihen me ligj në Republikën e Kosovës dhe me gjerë edhe në Arbitrazh Nderkombtar.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me çmimi në të lirë.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i Ri vlerësimit ka rekomanduar anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se ka mungesë të mjeteve financiare

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

OSHP ka nxjerr dy (2) vendime për këtë aktivitet të prokurimit: PSH Nr. 790/22 i publikuar me datë: 24/03/2023 dhe OSHP: Nr. 0212/2023 i publikuar me datën: 21/07/2023.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Eor Group SH.P.K.**

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit ka iniciuar aktivitet të prokurimit me titull: "Furnizim me Gjenerator" me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1, gjatë këtij aktiviteti ka zbatuar procedurë të hapur - lloji i kontratës është furnizim, vlerë e madhe, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët.

Vlenë të theksohet se përë procedurën në fjalë, janë nxjerrur dy (2) vendime me numër: PSH Nr. 790/22 i datës: 24.03.2023 dhe OSHP: 2023/0212 i datës: 21.07.2023.

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër, Vendimit të Autoritetit Kontraktues, AK ka rekomanduar anulimin e procedurës.

Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga PSH (OSHP) janë nxjerr 2 (dy) vendime me numër: OSHP: Nr. 0212/2023 i publikuar me datën: 21/07/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore nenit 59, 60 të LPP, të cituara në vendimin e OSHP. Dhe vendimi i PSH Nr. 790/22 i publikuar me datë: 24/03/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore nenit 7 dhe neni 11. Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara "res judikata" sipas nenit 105.2.16 të LPP –së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP –së.

Hyrje është e rëndësishme të kemi një pasqyrë të qartë të analizës së fakteve dhe argumenteve të dokumentuara ku jam bazuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Analiza e Fakteve dhe Argumenteve Eksperti shqyrtues, bazuar në platformën elektronike e-prokurimi, kam zhvilluar një analizë të kujdesshme të procedurës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit në fjalë. Në rrjedhën dhe analizën e kësaj procedure, nuk kam identifikuar prova dhe fakte konkrete që dëshmojnë mungesën e mjeteve financiare për këtë aktivitet. Kjo përfshinë edhe raportin e ri vlerësues të datës 01.11.2023.

Mungesa e provave dhe fakteve për mungesën e mjeteve financiare nga AK, raporti ri vlerësues ka shqyrtuar mundësinë e mungesës së mjeteve financiare për aktivitetin e prokurimit në fjalë. Megjithatë, sipas analizës së ekspertit, nuk janë ofruar prova dhe fakte konkrete që mbështesin këtë rekomandim për anulim të procedurës.

Rekomandimi për anulimin në raport dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ka një rekomandim për anulimin e aktivitetit të prokurimit në raportin e ri vlerësimit dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrave standarde. Megjithatë, përkundër këtij rekomandimi, raportin e ri vlerësimit dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrave standarde nuk ofron fakte dhe argumente të mjaftueshme që të mbështesin një vendim të tillë. Mungesa e fakteve të dokumentuar bën që ky rekomandim në raport dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues jetë pa baza. **citoj raportin:**

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Me kërkesë të Njësisë Kërkuese, pasi është konstatuar se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar për vazhdimin e procedures së aktivitetit të Prokurimit dhe me kërkesë të kësaj të fundit që ky aktivitet I prokurimit të mos procesohet në vazhdimësi. Gjithashtu, ne si komisioni i rivlersimit, duke u mbështetur ne te dhënat e larte shënuar rekomandojmë që ky aktivitet të anulohet, me arsyetimi sipas kërkesës të Njësisë Kërkuese për mungesë të mjeteve.

(Rekomandim nga komisioni i ri vlerësimit gjendet në raportin e vlerësimit pjesa e Deklaratës në nr e faqes 6).

Duke theksuar se nuk janë prezantuar fakte dhe argumente të mjaftueshme lidhur me pretendimet për mungesën e mjeteve financiare dhe rekomandimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e procedurës në fjalë. Gjithashtu, theksohet se ky anulim nuk përputhet dhe nuk është në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (LPP), veçanërisht Nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, si dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, Nenin 43 që ka të bëjë mendërprerjen e procedurave të prokurimit. Për këtë arsye, rekomandimi për anulim nuk ka baza të mjaftueshme ligjore dhe faktike për të mbështetur një vendim të tillë dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim është i bazuar.

Analiza e Fakteve dhe Argumenteve Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit raporti i Ri vlersimit është përgatitur me 31.10.2023 dhe është nënshkruar me datë 01.11.2023 duke u bazuar në vendimin me Nr: OSHP: 2023/0212 paragrafi 2 **Citoj:** 2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP, po ashtu duke u bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik neni 40, Ekzamimni, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve vrejm pika 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se **30 ditë** nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej **20 ditësh**. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura është tejkaluar afati kohor prej 30 ditëve dhe në rastet e jashtë zakonshme 20 ditë dhe në këtë rast nuk është respektuar nga AK Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurim Publik neni 40, po ashtu nuk kemi hasur në platformën elektronike njoftim/arsyeje për vonës të ri vlerësimit, duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura pretendimet ankimore janë të bazuara dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.

Në kuadër të pretendimeve ankimore, është vërejtur se OE (ankues) ka theksuar/potencuar se Autoriteti Kontraktues (AK) mund të ketë interesa të caktuara të individëve apo grupit të individëve në lidhje me këtë çështje. Është rëndësishme të theksohet se, për shkak të mungesës së kompetencës si ekspert në këtë fushë, nuk është e mundur të zhvillohet një analizë më tej mbi këtë aspekt në këtë kontekst.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së, dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Eor Group SH.P.K.**

Shkelzen Hoxha